

KANCERET E ORGANEVE RIPODHUESE

Çfarë janë kanceret e organeve riprodhuese?

Kanceret e organeve riprodhuese janë kancere që zhvillohen në organet riprodhuese femërore dhe mashkullore, dhe emërtohen sipas organit ku ato shfaqen.

Cilë janë kanceret e organeve riprodhuese femërore?

Kanceret e organeve riprodhuese më të zakonshme te femrat janë:

- Kanceri i gjirit: prek dy gjinj të femrës (por mund të prekë edhe meshkujt).
- Kanceri i qafës së mitrës: prek qafën e mitrës (fondi i poshtëm i mitrës që e lidh atë me vaginën).
- Kanceri i ovareve/vezoreve: prek vezoret, dy organet që prodhojnë hormonet femërore dhe vezët te një grua.
- Kanceri i mitrës: prek mitrën, organin ku rritet foshnja kur një grua është shtatzënë.
- Kanceri vaginal: prek vaginën, kanalën që del nga mitra në pjesën e jashtme të trupit.
- Kanceri vulvar: prek vulvën, pjesën hyrëse të organeve gjenitale femërore/zona rreth hapjes së vaginës.

A ekzistojnë teste për të kapur herët kanceret e organeve riprodhuese femërore?

Në faza të hershme të kancereve të organeve riprodhuese, shpesh femrat nuk kanë simptoma. Prandaj rekomandohen vizita të rregullta te një ofrues i kujdesit shëndetësor edhe atëherë kur nuk ka simptoma. Këto rrisin shumë gjasat që kanceret e organeve riprodhuese të identifikohen herët, gjatë vizitave të rregullta rutinë dhe testeve të depistimit.

Ekzistojnë teste depistuese vetëm për disa nga kanceret e organeve riprodhuese - për kancerin e gjirit dhe kancerin e qafës së mitrës:

- Mamografia: një test që përdoret për të zbuluar kancerin e gjirit. Rekomandohet që gratë mes moshës 50 dhe 70 vjeç të bëjnë një mamografi çdo 3-5 vjet. Gratë duhet të flasin me ofruesin e kujdesit shëndetësor për t'u informuar se kur duhet të fillojnë dhe sa shpesh duhet të bëjnë një mamografi.
- Pap testi dhe HPV testi: teste që përdoren për të zbuluar kancerin e qafës së mitrës. Duke filluar në moshën 25-30 vjeç, një femër duhet të bëjë një Pap test çdo 3 vjet dhe një HPV test çdo 5 vjet.

Nuk ka teste depistuese për kanceret e tjera të organeve riprodhuese femërore, por ekzistojnë teste diagnostikuese që mund të përdoren për të gjetur kancerin te femrat. Lloji i testit diagnostik të përdorur për gjetjen e kancerit riprodhues varet nga lloji i kancerit. Këto teste përfshijnë: testet laboratorike/testet e gjakut, rrezet-X, MRI scan, CT scan, biopsinë, etj.

Gjithashtu, për një femër është e rëndësishme që të paraqitet menjëherë te një ofrues i kujdesit shëndetësor nëse përjeton ndonjë simptomë. Kapja e kancerit herët mund të ndihmojë në rritjen e mundësisë që trajtimi të jetë i suksesshëm.

Çfarë janë kanceret e organeve riprodhuese mashkullore?

Kanceret e organeve riprodhuese më të zakonshme te meshkujt janë:

- Kanceri i gjëndrës së prostatës: prek prostatën, një gjëndër brenda legenit, në pjesën e poshtme të barkut.
- Kanceri i testikujve: prek testikujt, dy gjëndrat ku prodhohet sperma.
- Kanceri i penisit: prek penisin, pjesë e organeve gjenitale të jashtme mashkullore.

A ekzistojnë teste për të kapur herët kanceret e organeve riprodhuese mashkullore?

Për kancerin e prostatës ka teste depistuese. Nuk ka teste depistuese për kancerin e testikujve ose të penisit. Çdo lloj kanceri riprodhues ka simptoma të ndryshme, prandaj për meshkujt është e rëndësishme të paraqiten te një ofrues i kujdesit shëndetësor nëse venë re ndonjë shenjë, ndonjë gjëndër/kokërr apo diçka të pazakontë që dyshojnë se mund të jetë kancer. Kapja e kancerit qysh në fazat e para rrit mundësinë për rezultate trajtimi më të mira.

Nëse një person ka simptoma ose ka kryer një test që tregon nevojën për testime të mëtejshme për të përjashtuar kancerin, ofruesit e kujdesit shëndetësor ofrojnë teste diagnostikuese, të cilat janë të ndryshme në varësi nga lloji i kancerit.